

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU

Nr.faq/Br.str. 11
Datë/Datum. 01.02.2018
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**



Datë: 31.01.2018

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 29.01.2018, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 05, të datës 15.01.2018, paraqitur nga Kryesuesja e Kuvendit të Komunës, bazuar në nenin 11, nenin 40, shkronja (d), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, shkronja (dh), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, nenin 9, paragrafi 3, të Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës Nr. 62, të datës 16.05.2013 mori:

V E N D I M

Për formimin e Grupit Punues për Hartimin e Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2018

1. Për formimin e Grupit Punues për Hartimin e Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2018, në përbërje prej shtatë (7) anëtarëve si vijon:
 - 1.1 Vjollca Konjusha - Kryesuese e Kuvendit të Komunës, kryetare e grupit;
 - 1.2 Hasan Gjyrevci - Zyrtar Ligjor për Kuvend dhe Komitete, anëtar;
 - 1.3 Remzi Shala - Përfaqësues i LDK-së, anëtar;
 - 1.4 Aida Alimi - Përfaqësuese e PDK-së, anëtare;
 - 1.5 Eglantina Azemi - Përfaqësuese e LVV-së, anëtare;
 - 1.6 Driton Hasolli - Përfaqësues i AKR-së, anëtar;
 - 1.7 Slaxhana Lazic - Shefe e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, anëtare.
2. Detyrë e Grupit Punues është Hartimi i Planit Vjetor të Punës së Komitetit për Politikë e Financa, Komitetit për Komunitete dhe Kuvendit të Komunës për vitin 2018.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses të Kuvendit të Komunës, Anëtarëve të të Grupit Punues dhe Arkivës.

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës
Vjollca Konjusha**





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJË	
Nr.faq/Gr.str.	18
Data/Datum.	01.02.2018
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE	

Datë: 31.01.2018

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 29.01.2018, mbështetur në kërkesën Nr. 020-23/2, të datës 17.01.2018, të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në lidhje me rishqyrtimin e vendimit Nr. 03, të datës 05.01.2018, për themelimin e Komitetit për Politikë e Financa në Komunën e Fushë-Kosovës, bazuar në nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për anulimin e vendimit Nr. 03, të datës 05.01.2018

1. Anulohet vendimi Nr. 03, i datës 05.01.2018, për themelimin e Komitetit për Politikë e Financa në Komunën e Fushë-Kosovës, në përbërje prej gjashtë anëtarëve.
2. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës,
Anëtarëve të Komitetit për Politikë e Financa, Drejtorisë së FB,
Udhëheqësit të Personelit dhe Arkivës.**

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Vjollca Konjusha





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



	REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE GRUPOJA E ADMINISTRATËS - DIREKTOJATA ADMINISTRATIVE	
Nr.faq/Br.shr.		12
Data/Date		01.02.2018
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE		

Datë: 31.01.2018

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 29.01.2018, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 23, të datës 18.01.2018, paraqitur nga Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (e), nenin 51, paragrafi 51.1, nenin 52, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 4, paragrafi 1 dhe 2, nenin 5, nenin 6, nenin 7, paragrafi 5, të Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2014, për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të Përhershme në Komunë, nenin 27, shkronja (e), nenin 34, paragrafi 34.1, shkronja (a), nenin 35, nenin 37, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për themelimin e Komitetit për Politikë e Financa

1. Për themelimin e Komitetit për Politikë e Financa në Komunën e Fushë-Kosovës, në përbërje prej shtatë anëtarëve si vijon:
 - 1.1 Vjollca Konjusha - përfaqësuese nga Lidhja Demokratike e Kosovës, Kryesuese e Komitetit;
 - 1.2 Remzi Shala - përfaqësues nga Lidhja Demokratike e Kosovës, anëtar;
 - 1.3 Mirvete Gërguri - përfaqësuese nga Lidhja Demokratike e Kosovës, anëtare;
 - 1.4 Aida Alimi - përfaqësuese nga Partia Demokratike e Kosovës, anëtare;
 - 1.5 Doruntina Jashari - përfaqësuese nga Lëvizja Vetëvendosje, anëtare;
 - 1.6 Qerim Gara - përfaqësues nga Partia Demokratike e Ashkalinjve të Kosovës, anëtar;
 - 1.7 Driton Hasolli - përfaqësues nga Aleanca Kosova e Re, anëtar.
2. Detyrë dhe përgjegjësi e Komitetit për Politikë e Financa është shqyrtimi i të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik, kornizën vjetore afatmesme buxhetore, planin vjetor të prokurimit, rregulloren vjetore për tatimet, tarifrat dhe pagesat, planin vjetor të punës për auditimin e brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim gjatë vitit fiskal, si dhe marrjen e raportit nga Kryetari i Komunës dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin e Komunës.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës,
Anëtarëve të Komitetit për Politikë e Financa, Drejtorisë së FB,
Udhëheqësit të Personelit dhe Arkivës.**

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Vjollca Konjusha





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Stamp of the Municipality of Fushë-Kosovë / Kosovo-Polje, Directorate of Administration. It includes the number 17 and the date 01.02.2018.



Datë: 31.01.2018

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 29.01.2018, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 22, të datës 18.01.2018, paraqitur nga Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (e), nenin 50, paragrafi 51.1, nenin 53, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 4, paragrafi 1 dhe 2, nenin 8, nenin 9, nenin 10, nenin 13, të Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2014, për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të Përhershme në Komunë, nenin 27, shkronja (e), nenin 34, paragrafi 34.1, shkronja (b), nenin 36, nenin 38 të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për themelimin e Komitetit për Komunitete

1. Për themelimin e Komitetit për Komunitete në Komunën e Fushë-Kosovës, në përbërje prej shtatë anëtarëve si vijon:
 - 1.1 Arjeta Jashari - përfaqësuese nga Lidhja Demokratike e Kosovës, anëtar;
 - 1.2 Migjen Kolshi - përfaqësues nga Partia Demokratike e Kosovës, anëtar;
 - 1.3 Durim Hajra - përfaqësues nga Lëvizja Vetëvendosje, anëtar;
 - 1.4 Ljubisa Cirkovic - përfaqësues i komunitetit serb nga Iniciativa Qytetare Serbe, anëtar;
 - 1.5 Rexhep Hyseni - përfaqësues nga komuniteti ashkali, anëtar;
 - 1.6 Xhemajl Hasani - përfaqësues nga komuniteti egjiptas, anëtar;
 - 1.7 Fehmi Gashi - përfaqësues nga komuniteti rom, anëtar.
2. Komuniteti i Komiteteve është përgjegjës për shqyrtimin e përputhshmërisë së autoriteteve komunale me ligjin në zbatimin dhe shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për t'u siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht. Komiteti gjithashtu i rekomandon Kuvendit të Komunës masat që duhet të ndërmerren për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komuniteteve për t'u avancuar, shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor, si dhe për të siguruar mbrojtje adekuate të të drejtave të komuniteteve brenda komunës.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës,
Anëtarëve të Komitetit për Komunitete, Drejtorisë së FB,
Udhëheqësit të Personelit dhe Arkivës.**

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Vjollca Konjusha



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU
Ortëq/Dele: 13
Data/Datum: 01.02.2018
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE

Datë: 31.01.2018

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 29.01.2018, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 20, të datës 15.01.2018, paraqitur nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (c), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (a, g, l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 10, paragrafi 10.2, të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr. 03/L-049, nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (c), nenin 27, shkronja (b, f, nj), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për aprovimin në parim të Propozimit për vazhdimin e lirimit nga taksat për ushtrimin e aktiviteteve biznesore të subjekteve afariste në Komunën e Fushë-Kosovës, për vitin kalendarik 2018 dhe dërgimin e tij në procedurën e diskutimit publik

1. Për dërgimin në procedurën e diskutimit publik të ndryshimit të 'Rregullores për tarifa ngarkesa dhe gjoba komunale, Nr. 63', të datës 16.05.2013, duke e propozuar vazhdimin e shfuqizimit të nenit 8 të Rregullores për vitin 2018, në funksion të krijimit të lehtësimeve për bizneset ekzistuese dhe avantazhe për hapjen e bizneseve të reja dhe gjenerim të punësimit.
2. Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik ka vlerësuar nevojën për vazhdimin e lirimit nga taksa të bizneseve për vitin kalendarik 2018 dhe do të ofrojë informata e sqarime të nevojshme për opinionin-subjektet afariste, në debatin publik.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së ZHE dhe Arkivës.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Vjollca Konjusha





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 31.01.2018

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 29.01.2018, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 19, të datës 15.01.2016, paraqitur nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, mbështetur në kërkesën Nr. 11, të datës 10.01.2018, e parashtuar nga CARITAS Kosova, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, shkronja (ç), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për vazhdimin e realizimit të projektit ‘Ngritja e përkujdesit social dhe shëndetësor në Komunën e Fushë-Kosovës, në bashkëpunim dhe bashkëfinancim me CARITAS Kosova për vitin 2018’


1. Aprovohet Propozimi Nr. 19, i datës 15.01.2018, për lejin e mjeteve financiare, në shumë të përgjithshme prej 242,848.76€, për vazhdimin e realizimit të projektit ‘Ngritja e përkujdesit social dhe shëndetësor në Komunën e Fushë-Kosovës, në bashkëpunim dhe bashkëfinancim me ‘CARITAS Kosova’ për vitin 2018’.
2. Shuma e mjeteve financiare nga buxheti i komunës, për vazhdimin e realizimit të projektit sipas pikës një (1) të vendimit, lejohet nga kodet ekonomike të projekteve si vijon:
 - 2.1 Nga organizata buxhetore Nr. 612, programi Nr. 18162, kodi i projektit Nr. 44714 për mirëmbajtje, pastrim të ambientit, ngritja e përkujdesit social, shëndetësor, shtëpiak, ambulator, administrativ, ekonomik, infrastrukturor, e tjera, lejohet shuma e mjeteve financiare prej 200,000.00€;
 - 2.2 Nga organizata buxhetore Nr. 612, programi Nr. 17502, bashkëfinancim i projekteve, Nr. 44684, lejohet shuma e mjeteve financiare prej 22,818.76€.
3. Për vazhdimin e realizimit të projektit, sipas pikës një (1) të vendimit, CARITAS Kosova, financohet me mjete financiare në shumë prej 20,030.00€.
4. Me vazhdimin e realizimit të këtij projekti të punësimit në bashkëfinancim me CARITAS Kosova për vitin 2018, përqindja e numrit të punësuarve mbetet në favor të arsimit e shëndetësisë dhe ndihmohen qytetarët e Komunës së Fushë-Kosovës në ofrimin e shërbimeve për përmirësimin e kushteve të jetesës:

- 4.1 Shërbimet sociale - edukative dhe shëndetësore për përmirësimin e kushteve të varfërisë për shtresat sociale;
- 4.2 Vazhdimin e përkrahjes financiare të punësimit të qytetarëve të komunës tonë - punëtorë në veprimtari të ndryshme sociale dhe edukative;
- 4.3 Parandalimi i procesit të migrimit ilegal nëpërmjet krijimit të vendeve të punës;
- 4.4 Përkujdesje sociale dhe shëndetësore për familjet e komuniteteve: rom, ashkalinj dhe egjiptas.
5. Kryerja e procedurave tjera, lidhja e marrëveshjes për vazhdimin e bashkëpunimit dhe bashkëfinancimit me CARITAS Kosova dhe sigurimi i mjeteve financiare nga buxheti i komunës, sipas pikës (2) të vendimit, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit dhe Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.
6. Për rezultatet e arritura në punë përmes punësimit me këtë projekt të përbashkët të bashkëpunimit dhe bashkëfinancimit ndërmjet Komunës së Fushë-Kosovës dhe CARITAS Kosova, si bashkërealizues në realizimin e projektit të punësimit informohet me shkrim Kryetari i Komunës dhe Kuvendi i Komunës.
7. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Drejtorisë së SHMS, Drejtorisë së ADM, Drejtorisë së ARSIMIT, Drejtorisë së SHPM dhe Arkivës.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Vjollca Konjusha





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA	
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE	
DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKTORIA ZA ADMINISTRACIJU	
Nr./No./Dr./str.	15
Data/Datum	01.02.2018
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE	

Datë: 31.01.2018

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 29.01.2018, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 20, të datës 15.01.2018, mbështetur në kërkesën e Këshillit të Bashkësisë Islame në Fushë-Kosovë Nr. 02-070/05-0001035/18, të datës 11.01.2018 dhe kërkesën e përfaqësuesit të Kishës Ortodokse Serbe në Fushë-Kosovë Nr. 02-070/05-0000823/18, të datës 10.01.2018, bazuar në nenin 11, nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për vazhdimin e mbulimit të shpenzimeve të varrimit për vitin 2018

1. Për vazhdimin e mbulimit të shpenzimeve të varrimit për qytetarët me vendbanim të përhershëm në Komunën e Fushë-Kosovës për vitin 2018, në shumë të mjeteve financiare nga buxheti i komunës prej 165€ për çdo ceremoni të varrimit, përfshirë të gjitha komunitetet fetare.
2. Sigurimi i mjeteve financiare, sipas pikës një të vendimit nga buxheti i komunës, për vitin 2018, është në kompetencë të Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit.
3. Kryerja e procedurave tjera për zbatimin e vendimit është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Financave e Buxhetit dhe Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedisit.
4. Për shpenzimin e mjeteve financiare të lejuara, përfaqësuesit e Bashkësisë Islame të Fushë-Kosovës, Kishës Ortodokse dhe bashkësive tjera fetare i raportojnë me shkrim Kuvendit të Komunës.
5. Ky vendim shfuqizon vendimin Nr. 174, të datës 30.12.2016 dhe hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Drejtorisë së SHPM, Palëve dhe Arkivës.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës


Vjollca Konjusha





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 31.01.2018

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 29.01.2018, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 19, të datës 15.01.2018, paraqitur nga Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 11, nenin 17, shkronja (a, c), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (b, c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (a, c), nenin 27, shkronja (c, ç) të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për lejimin e mjeteve financiare në shumë të përgjithshme prej 297,800.00€, nga 'Kodi i bashkëfinancimit, subvencioneve dhe transfereve dhe mbetja nga participimi i fermerëve', për realizimin e projekteve për zhvillimin e bujqësisë në vitin 2018

1. Lejohet shpenzimi i mjeteve financiare, në shumë të përgjithshme prej 297,800.00€, prej 'Kodit të bashkëfinancimit, subvencioneve dhe transfereve, ku hyn edhe mbetja nga participimi i fermerëve në vitin 2017, shuma e mjeteve financiare prej 66,808.00€ dhe participimi i fermerëve të komunës për vitin 2018, shuma e mjeteve financiare prej 43,800.00€', për realizimin e projekteve për zhvillimin e bujqësisë në vitin 2018 si vijon:
 - 1.1 Mjetet financiare, në shumë prej 75,000.00€, nga buxheti i komunës dhe mjetet financiare në shumë prej 15,000.00€ ose 20% nga bashkëfinancimi i fermerëve destinohen për realizimin e projektit për blerjen e 'Serrave';
 - 1.2 Mjetet financiare, në shumë prej 70,000.00€, nga buxheti i komunës dhe mjetet financiare në shumë prej 14,000.00€ ose 20% nga bashkëfinancimi i fermerëve destinohen për realizimin e projektit për blerjen e 'Motokultivatorëve';
 - 1.3 Mjetet financiare, në shumë prej 10,000.00€, nga buxheti i komunës dhe mjetet financiare në shumë prej 2,000.00€ ose 20% nga bashkëfinancimi i fermerëve destinohen për realizimin e projektit për blerjen e 'Spërkatësve për traktorë';
 - 1.4 Mjetet financiare, në shumë prej 4,000.00€, nga buxheti i komunës dhe mjetet financiare në shumë prej 800.00€ ose 20% nga bashkëfinancimi i fermerëve destinohen për realizimin e projektit për blerjen e 'Ciklonëve - Shpërndarësve të plehut artificial';
 - 1.5 Mjetet financiare, në shumë prej 15,000.00€, nga buxheti i komunës dhe mjetet financiare në shumë prej 3,000.00€ ose 20% nga bashkëfinancimi i fermerëve destinohen për realizimin e projektit për blerjen e 'Pajisjeve bletare';
 - 1.6 Mjetet financiare, në shumë prej 35,000.00€, nga buxheti i komunës dhe mjetet financiare në shumë prej 7,000.00€ ose 20% nga bashkëfinancimi i fermerëve destinohen për realizimin e projektit për blerjen e 'Mekanizmit bujqësor';

- 1.7 Mjetet financiare, në shumë prej 5,000.00€, nga buxheti i komunës dhe mjetet financiare në shumë prej 1,000.00€ ose 20% nga bashkëfinancimi i fermerëve destinohen për realizimin e projektit për blerjen e 'Makinave mjelëse';
- 1.8 Mjetet financiare, në shumë prej 5,000.00€, nga buxheti i komunës dhe mjetet financiare, në shumë prej 1,000.00€ ose 20% nga bashkëfinancimi i fermerëve destinohen për realizimin e projektit për blerjen e 'Inkubatorëve';
- 1.9 Mjetet financiare, në shumë prej 15,000.00€, nga buxheti i komunës me destinim për realizimin e projektit për blerjen e 'Folive';
- 1.10 Mjetet financiare, në shumë prej 10,000.00€, nga buxheti i komunës me destinim për realizimin e projektit për blerjen e 'Plehut artificial';
- 1.11 Mjetet financiare, në shumë prej 10,000.00€, nga buxheti i komunës me destinim për realizimin e projektit për blerjen e 'Pemëve'.
2. Në realizimin e projekteve për zhvillimin e bujqësisë, sipas pikës një (1) të vendimit, nën pikave 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5, 1.6, 1.7 dhe 1.8, participojnë fermerët e komunës së Fushë-Kosovës në vitin 2018 me mjete financiare në shumë të përgjithshme prej 43,800.00€.
3. Kryerja e procedurave tjera për sigurimin e mjeteve financiare në shumë të përgjithshme prej 297,800.00€ nga buxheti i komunës, ku hyn edhe mbetja nga participimi i qytetarëve në bujqësi për vitin 2017, në shumë prej 66,808.00€, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Financave e Buxhetit dhe Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Zyrës së Prokurimit, Drejtorisë së BZHR dhe Arkivës.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Vjollca Konjusha